

Trusti

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

STATUTI

14 dhjetor 2023

Ky Statut është miratuar nga Bordi Drejtues i FKPK-së më 31 tetor 2023.

Ky Statut e ka marrë pajtimin nga Banka Qendrore e Kosovës më 14 dhjetor 2023.

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	3
KREU II	AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E FKPK-SË	6
KREU III	BORDI DREJTUES, PËRBËRJA, ZGJEDHJA, MANDATI	11
KREU IV	MBLEDHJET E BORDIT DREJTUES	13
KREU V	KOMISIONET	15
KREU VI	TË DREJTAT, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES	17
KREU VII	KONTRIBUTET DHE PAGESA E TYRE	19
KREU VIII	ADMINISTRIMI I FKPK-SË	21
KREU IX	TË NDRYSHME	24
KREU X	LIGJI I ZBATUESHËM DHE INTERPRETIMI.....	25
KREU XI	DISPOZITA KALIMTARE.....	25
KREU XII	DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	25

Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-101, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin 04/L-168, 05/L-116 dhe me ligjin 07/L-016, për Fondet Pensionale të Kosovës, me Vendimin Nr. 2023-24, të datës 31 tetor 2023, e miratoi:

STATUTIN E FONDIT TË KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1.1 Me këtë Statut përcaktohen parimet themelore për organizimin dhe punën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Bordit Drejtues dhe Administratës së FKPK-së.

Neni 2 Përkufizimet

2.1 Të gjitha termat në këtë Statut kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuara në Nenin 1 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, me të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e tij, dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e këtij Statuti:

- 2.1.1 **Aksion** - Instrument financiar që siguron pronësi në një kompani, varësisht nga shkalla e investimit.
- 2.1.2 **Anëtar i Bordit Drejtues**- “Anëtar” nënkupton cilindo prej Anëtarëve/Anëtareve të Bordit Drejtues, të zgjedhur apo sipas detyrës.
- 2.1.3 **ATK** - Administrata Tatimore e Kosovës - një njësi brenda Ministrisë së Financave, përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në Kosovë.
- 2.1.4 **Bono** - Instrument financiar i emtuar nga qeveritë ose korporatat, me afat origjinal maturimi 12 (dymbëdhjetë) muaj ose më pak.
- 2.1.5 **Bordi Drejtues** - “Bordi Drejtues” ose “Bordi” është organ i përbërë prej tetë Anëtarësh të Bordit Drejtues të FKPK-së, që shërbejnë si Njerëz të Besueshëm (Fiduciarë), sipas LFP-së.
- 2.1.6 **BQK** - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, që është përgjegjës, si institucion i pavarur, sipas nenit 140 të Kushtetutës, për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, siguruesve të pensioneve, menaxhuesve të mjeteve dhe instrumenteve për investime të hapura, si dhe mbajtësve sipas këtij ligji, dhe ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.
- 2.1.7 **Broker** - ndërmjetësit e përzgjedhur për investimet e drejtpërdrejta në letra me vlerë (aksione, obligacione, ETF apo ETC).
- 2.1.8 **Deklarata e parimeve të investimit** - nënkupton politikën investuese dhe objektivat e zhvillimit të investimeve të përshtatura nga FKPK-ja për investimin e mjeteve të pensioneve, e cila duhet të jetë në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e BQK-së për pensione, ose me direktivat e investimit, të cilat entiteti i pensionit ia përcakton menaxherëve të mjeteve ose mbajtësit.
- 2.1.9 **ETC ose “Mallrat e tregtuara në bursë”** - Fond i tregtuar në bursë i përbërë vetëm nga mallrat bazë (*commodities*).
- 2.1.10 **ETF ose Fond i tregtuar në bursë** – Letër me vlerë e tregtueshme në bursë, që në përmbajtje ka një numër të letrave me vlerë, të një apo më shumë klasave të instrumenteve financiare, të tilla si: aksione, fletobligacione, mallra e të tjera.

- 2.1.11 **Fletobligacion** - Instrument financiar i bonove ose obligacioneve.
- 2.1.12 **Instrument për investime të hapura/fonde investuese** - investim përmes subjekteve të organizuara, që veprojnë si kompani investuese dhe të cilët janë të autorizuar të emetojnë numër të pakufizuar të aksioneve të kapitalit (në njësi të pjesshme apo të plota), duke paraqitur pronësi të barabartë proporcionale në subjektet e tilla nga aksionari apo policave të sigurimit ku pasuria kryesore grumbullohet për qëllime investuese. Kjo shprehje përfshin fondet reciproke, fondet investuese, fondet e njësave, policat e sigurimit dhe mjetet e tjera investuese, të cilët veprojnë në bazë të grumbullimit.
- 2.1.13 **Kryesuesi i Bordit Drejtues** - “Kryesuesi” nënkupton personin e zgjedhur si Kryesues i Bordit Drejtues sipas LFP-së, ose si Ushtrues Detyre i Kryesuesit, siç mund ta përcaktojë Kryesuesi. Anëtari i emëruar si Kryesues duhet të jetë njëri nga anëtarët e Bordit me të drejtë vote.
- 2.1.14 **Letrat me Vlerë** - Instrumente financiare, të tregtueshme në bursë publike, të tilla si aksionet, fletobligacionet, fondet e tregtuara në bursë, mallrat, derivativet.
- 2.1.15 **Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës** - në tekstin e mëtejme LFP, nënkupton Ligjin Nr. 03/L-084, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-101, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe me Ligjin Nr. 05/L-116 të Republikës së Kosovës, apo amendamentet dhe plotësimet e tjera që ky ligj mund t’i pësojë në të ardhmen.
- 2.1.16 **Mbajtës** - një fiduciar që është bankë e licencuar dhe person juridik në Kosovë ose filial i një banke të huaj, që është person juridik i licencuar, për të kryer biznes në Kosovë nga BQK, ose është licencuar për të kryer biznes në cilindo shtet anëtar të OBZHE-së nga autoriteti mbikëqyrës bankar i atij shteti, që ofron shërbime për ruajtje dhe depozitim të FKPK-së ose fondeve pensionale a personave që sigurojnë pensione plotësuese individuale, që lidhen me mjetet pensionale në bazë të marrëveshjes për ruajtje të tillë.
- 2.1.17 **Menaxhuesi i mjeteve** - një fiduciar (i besuar), i cili është person juridik i licencuar nga BQK-ja, ose nga ndonjë organ tjetër rregullues i tregut të kapitalit në Kosovë (ose trashëguesi i tij), ose nga një organ i tregjeve të kapitalit të shteteve anëtare të OBZHE-së, që investon apo i menaxhon mjetet ose siguron këshilla lidhur me investimet e FKPK-së në bazë të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve.
- 2.1.18 **Obligacion** - instrument financiar i emtuar nga qeveritë ose korporatat, me afat origjinal maturimi mbi 12 (dymbëdhjetë) muaj.
- 2.1.19 **OBZHE** – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.
- 2.1.20 **Organizimi, Politikat dhe Procedurat** - në tekstin e mëtejme OPP, nënkupton një akt të brendshëm, të miratuar nga Bordi Drejtues i FKPK-së, i cili i përshkruan në detaje përgjegjësitë, politikat dhe procedurat e kërkuara për të siguruar administrimin efektiv të FKPK-së, siç kërkohet nga LFP-ja dhe Rregulloret.
- 2.1.21 **Pjesëmarrës** - person fizik në emër të të cilit punëdhënësi ose pjesëmarrësi i paguan kontributet në FKPK.
- 2.1.22 **Portofol** - nënkupton ndarjen e mjeteve të pensionit në strategji të ndryshme investuese, dhe risku i investimeve përshtatet me moshën e pjesëmarrësit. Çmimi i njësisë dhe performanca e investimeve të instrumenteve financiare (aksione, bono, para të gatshme, ETF dhe të tjera) është e veçantë për secilin portofol.

2.1.23 **Rregulloret** - “Rregulloret” apo “Rregullat” nënkuptojnë aktet nënligjore, gjegjësisht Rregulloret dhe Rregullat e nxjerra nga BQK-ja, në përputhje me LFP-në, si dhe udhëzimet e tjera administrative që e rregullojnë fushën e pensioneve.

Neni 3 Institucioni i FKPK-së, Misioni dhe veprimtaria

- 3.1 Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (më tej “FKPK”) është person juridik i pavarur i krijuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me Ligjin për Fondet Pensionale në Kosovë.
- 3.2 FKPK-ja është themeluar me qëllim të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime; investimit të kujdesshëm dhe ruajtjes së mjeteve pensionale; si dhe pagimit të të ardhurave që krijohen në llogaritë individuale për blerjen e pensioneve vjetore, për pensionet e bazuara në kursime.
- 3.3 FKPK-ja gëzon pavarësi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të saj funksionale, organizative dhe në administrimin financiar në pajtim me LFP-në.
- 3.4 FKPK-ja i raporton Kuvendit dhe mbikëqyret nga BQK-ja, në përputhje me LFP-në.

Neni 4 Statusi juridik

- 4.1 FKPK-ja e ka statusin e personit juridik jofitimprurës dhe është subjekt i të drejtave dhe detyrimeve.
- 4.2 FKPK-ja është e aftë për të paditur dhe për t’u paditur në emër të vet.
- 4.3 Veprimtaria e FKPK-së kryhet në përputhje me Ligjet e Kosovës.
- 4.4 FKPK-ja gëzon pavarësi organizative, administrative dhe buxhetore.

Neni 5 Emërtimi

- 5.1 Emërtimi zyrtar i Institucionit në gjuhën shqipe është: Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, ndërkaq shkurtesa është **FKPK**.
- 5.2 Emërtimi zyrtar i Institucionit në gjuhën serbe është: Kosovski Penzijski Štedni Fond, ndërkaq shkurtesa është **KPŠF**.
- 5.3 Emërtimi zyrtar i Institucionit në gjuhën angleze është: Kosovo Pension Savings Trust, ndërkaq shkurtesa është **KPST**.

Neni 6 Selia, Vula, Logo, Hapësirat dhe Llogaritë

- 6.1 Selia e FKPK-së është në Prishtinë.
- 6.2 FKPK-ja e ka vulën e vet, forma dhe përmbajtja e së cilës përcaktohet në përputhje me Ligjin për Vulat e institucioneve të Republikës së Kosovës.
- 6.3 FKPK-ja e ka logon e vet. Logoja e FKPK-së vendoset në hapësirat e FKPK-së, në dokumente e akte të brendshme, në komunikimet e stafit me palët e treta, në botime e publikime ose në aktivitete, të cilat organizohen nga FKPK-ja.
- 6.4 FKPK-ja mund të vendosë të blejë, ndërtojë apo të marrë me qira hapësirat e nevojshme për kryerjen e funksioneve të FKPK-së në mënyrë të përshtatshme.
- 6.5 FKPK-ja mban llogari bankare në bankat e licencuara në Kosovë apo jashtë saj.

Neni 7 Organet drejtuese

Organet drejtuese të FKPK-së janë Bordi Drejtues dhe Drejtori Menaxhues.

KREU II AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E FKPK-SË

Neni 8 Përzgjedhja e mbajtësit të mjeteve dhe marrëveshja për mbajtje

- 8.1 Për investimet të cilat bëhen përmes menaxhuesve të mjeteve, nevojitet mbajtësi i mjeteve, i cili përzgjidhet nga FKPK-ja me konkurs ndërkombëtar.
- 8.2 Të gjitha procedurat lidhur me përzgjedhjen e mbajtësit të mjeteve udhëhiqen nga FKPK-ja.
- 8.3 Kushtet dhe procedura për udhëheqjen e konkursit, duke përfshirë edhe kërkesat paraprake të kualifikimit për mbajtësin, shumën dhe përbërjen e aksioneve të tij, arsyet dhe procedura e pezullimit ose anulimit të licencës së tij, përcaktohen në përputhje me LFP-në.
- 8.4 Marrëveshja për mbajtje mes FKPK-së dhe mbajtësit të mjeteve duhet të përfshijë kushtet e parapara në LFP.
- 8.5 FKPK-ja mund të kërkojë dhe pranojë informacionet nga mbajtësit e mjeteve dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për të gjitha transaksionet në emër të FKPK-së, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që i mban FKPK-ja.
- 8.6 FKPK-ja mund të bëjë shkarkimin dhe zëvendësimin e mbajtësve të mjeteve dhe kryerësve të tjerë të shërbimeve të FKPK-së.

Neni 9 Përzgjedhja e menaxhuesit të mjeteve

- 9.1 Për investimin dhe menaxhimin e një pjese apo tërësisë së mjeteve, Bordi mund të angazhojë një apo më shumë menaxhues të mjeteve, përmes konkursit ndërkombëtar.
- 9.2 Të gjitha procedurat lidhur me përzgjedhjen e menaxhuesit të mjeteve, udhëhiqen nga FKPK-ja.
- 9.3 Kushtet dhe procedura e shpalljes, duke përfshirë edhe kërkesat para kualifikuese për menaxhuesit e mjeteve, shumën dhe përbërjen e kapitalit dhe kërkesat e tjera përcaktohen në përputhje me LFP-në.
- 9.4 Marrëveshja për menaxhimin e mjeteve parasheh menaxhimin e mjeteve pensionale, vetëm përmes mbajtësit të emëruar.
- 9.5 Menaxhuesit e mjeteve, menaxhojnë mjetet e FKPK-së në përputhje me marrëveshjet me FKPK-në, të lidhura në pajtim me Ligjin dhe me rregulloret e tjera në fuqi.
- 9.6 Menaxhuesit e mjeteve dhe punonjësit e tyre që kanë liri veprimi me mjetet pensionale duhet të jenë fiduciarë të FKPK-së.
- 9.7 FKPK-ja mund të kërkojë dhe pranojë informacionet nga menaxhuesit e mjeteve për të gjitha transaksionet në emër të FKPK-së, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që i mban FKPK-ja.
- 9.8 FKPK-ja mund të bëjë shkarkimin dhe zëvendësimin e menaxhuesit të mjeteve të FKPK-së.

Neni 10 Përzgjedhja e instrumenteve për investime të hapura

- 10.1 Bordi i FKPK-së mund të përcaktojë, se investimet optimale për një pjesë të mjeteve pensionale apo për të gjitha mjetet pensionale të FKPK-së, të bëhen përmes instrumentit për investime të hapura.
- 10.2 FKPK-ja përmes konkursit ndërkombëtar mund të zgjedhë një apo më shumë instrumente për investime të hapura.
- 10.3 Kushtet dhe procedurat e shpalljes së konkursit, duke përfshirë kushtet parakualifikuese dhe kushtet e tjera, përcaktohen në përputhje me LFP-në.

- 10.4 Dispozitat lidhur për mbajtësit e mjeteve nuk zbatohen për mjetet pensionale të investuara përmes instrumenteve për investime të hapura.
- 10.5 FKPK-ja i realizon investimet në instrumentet për investime të hapura përmes abonimit në to, duke nënshkruar formularin përkatës për mandatblerje të njëjësive.
- 10.6 FKPK-ja mund të ndërpresë investimin në instrumentet për investime të hapura përmes shitjes së njëjësive përkatëse, të cilat i posedonte.
- 10.7 FKPK-ja mund të rikthejë abonimin në një fond nga i cili i ka tërhequr të gjitha njësitë.

Neni 11 Përzgjedhja e Letrave me vlerë

- 11.1 Bordi i FKPK-së mund të përcaktojë se investimet për një pjesë të mjeteve pensionale të FKPK-së, të bëhen përmes investimeve direkte në Letra me vlerë të cilat tregtohen publikisht në bursa.
- 11.2 Letrat me vlerë përzgjidhen bazuar në analizë dhe në përputhje me Deklaratën e Parimeve të Investimeve.
- 11.3 Shitblerja e Letrave me vlerë bëhet përmes brokerëve, siç përcaktohet në këtë Statut dhe aktet e tjera, që burojnë nga i njëjti.

Neni 12 Përzgjedhja e Brokerëve

- 12.1 Për investimet e drejtpërdrejta në fonde të tregtueshme në bursa dhe në Letra të tjera me vlerë, FKPK-ja e bën përzgjedhjen e brokerëve përmes konkursit ndërkombëtar.
- 12.2 Të gjitha procedurat për përzgjedhjen e brokerëve udhëhiqen nga FKPK-ja.
- 12.3 Brokerët duhet të licencohen nga autoriteti i tregut financiar në Kosovë ose nga autoriteti i tregut financiar i një shteti anëtar të OBZHE-së.
- 12.4 Kushtet dhe procedurat e shpalljes së konkursit, duke përfshirë kushtet parakualifikuese për brokerë si dhe çfarëdo kushti tjetër, përcaktohen nga Bordi.
- 12.5 Në rastet kur Brokëri i jep FKPK-së edhe shërbimet e mbajtjes së mjeteve, për mjetet e investuara përmes atij Brokëri, dispozitat për mbajtje, të parapara në këtë Statut, nuk zbatohen.

Neni 13 Deklarata e Parimeve të Investimeve

- 13.1 Bordi, në bazë të këshillave profesionale, në përputhje me LFP-në dhe Rregulloret në fuqi, përgatit dhe miraton Deklaratën e Parimeve të Investimeve në harmoni me parimet e paraqitura në këtë Statut.
- 13.2 Në Deklaratën e Parimeve të Investimeve parashtrohen:
 - (a) Mënyra me të cilën plotësohen kushtet e LFP-së;
 - (b) Llojet e mjeteve në të cilat mund të investohen mjetet pensionale, kushtet për përzgjedhjen e tyre; dhe për çdo klasë mjetesh, ekspozimin maksimal në to dhe ndaj një emetuesi të vetëm ose grup emetuesish të ndërlidhur;
 - (c) Palët përgjegjëse për vendimet lidhur me sigurimin dhe realizimin e investimeve;
 - (d) Procedurat e nxjerrjes së vendimeve; dhe
 - (e) Metodatat e ndryshimit të deklaratave.
- 13.3 Mjetet e FKPK-së investohen vetëm në pajtim me dispozitat e LFP-së dhe në interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve; me qëllim të rritjes së fitimit në investim mbi bazën e investimit të arsyeshëm.
- 13.4 Qëllimet e një investimi të arsyeshëm të mjeteve pensionale janë:
 - (a) Siguria e mjeteve pensionale;
 - (b) Shumëllojshmëria e investimit;

- (c) Fitimi maksimal në përputhje me sigurinë e mjeteve pensionale; dhe
 - (d) Mirëmbajtja e likuiditetit adekuat.
- 13.5 Bordi i FKPK-së e shqyrton deklaratën e parimeve të investimit, sa herë që e vlerëson të nevojshme por jo më pak se një herë në vit, e nëse është e nevojshme, e ndryshon atë.
- 13.6 Bordi i FKPK-së mund të përfshijë, në deklaratën e parimeve të investimeve të tij, një udhëzim për ndarjen e mjeteve pensionale në portofolio të veçanta, me qëllim që grup moshat e ndryshme të pjesëmarrësve, të sigurohen me një profil përkatës të rrezikut që i përshtatet moshës së pjesëmarrësit.

Neni 14 Mbarëvajtja operacionale

- 14.1 FKPK-ja, për kryerjen e detyrave të veta, sipas nevojës dhe procedurave të detajuara në aktet e brendshme, në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë, e duke respektuar parimet bazë të administrimit të mirë, mund të lidhë marrëveshje për:
- (a) Blerjen, shitjen apo marrjen me qira të patundshmërive.
 - (b) Furnizimin me pajisje dhe materiale të nevojshme për funksionim dhe administrim.
 - (c) Kontraktim të shërbimeve profesionale të nevojshme.

Neni 15 Punësimi nga FKPK-ja

- 15.1 FKPK-ja për kryerjen e detyrave të veta, sipas nevojës dhe procedurave të detajuara në akte të tjera të brendshme, në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë, e duke respektuar parimet bazë të administrimit të mirë, bën punësimin e:
- (a) Personelit ekzekutiv.
 - (b) Personelit jo ekzekutiv.

Neni 16 Marrëveshjet e sigurimeve

- 16.1 FKPK-ja, për ta siguruar Bordin si dhe stafin gjatë kryerjes së detyrave të tyre, sipas nevojës dhe procedurave të detajuara, në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë, e duke respektuar parimet bazë të administrimit të mirë, mund të lidhë marrëveshje të sigurimeve, përfshirë sigurimin fiduciar, me kompanitë e licensuara në Kosovë ose në shtetet anëtare të OBZHE-së.

Neni 17 Taksa operacionale dhe investuese

- 17.1 Të gjitha aktivitetet që financohen e që lidhen me mbarëvajtjen e funksioneve operacionale të FKPK-së, financohen nga taksa operacionale.
- 17.2 Të gjitha aktivitetet që lidhen me investimin e mjeteve pensionale nga FKPK-ja, financohen nga taksa investuese.
- 17.3 Lartësia e taksës operacionale dhe asaj investuese shprehet në përqindje dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës në baza vjetore, duke u bazuar në kërkesën e FKPK-së.
- 17.4 FKPK-ja mund të parashtrojë kërkesë për taksë investuese shtesë, varësisht nga aktiviteti financiar dhe lëvizjet e çmimeve në treg. Kërkesa duhet të jetë e specifikuar dhe e arsyetuar, e cila pasqyron aktivitetin shtesë dhe çmimin e aktiviteteve financiare për të cilat kërkohet taksa shtesë.
- 17.5 Kërkesa e FKPK-së për caktimin e taksës operacionale dhe investuese, duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përlogaritura për periudhën për të cilën paraqitet kërkesa.
- 17.6 Në rast se Kuvendi nuk mund të miratojë taksën operacionale dhe investuese për vitin vijues, taksat e vitit paraparak mbesin në fuqi, deri në vendimin e ri të Kuvendit.

Neni 18 Buxheti i FKPK-së

- 18.1 Buxheti i FKPK-së përgatitet duke pasur parasysh nevojat e FKPK-së për vitin pasues, duke i respektuar afatet e përcaktuara si dhe procedurat për përpilimin e buxhetit, të parapara në aktet e brendshme.
- 18.2 Buxhetin e FKPK-së e miraton Bordi Drejtues. Kryesuesi e drejton përgatitjen e buxhetit vjetor të FKPK-së, duke përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat, siç janë taksat dhe transferimet nga të ardhurat e përgjithshme dhe ato ia paraqet Bordit Drejtues për miratim.
- 18.3 Ri-alokimi i mjeteve midis linjave buxhetore mund të bëhet vetëm me vendim të Bordit Drejtues. Një rishikim i plotë i nevojës për ri-alokime, apo ndryshim të buxhetit në përgjithësi, duhet të trajtohet në tremujorin e tretë të vitit.
- 18.4 Bordi krijon rezervë operationale dhe përcakton lartësinë e saj me vendim dhe i njëjti përshkruhet në aktet e brendshme.
- 18.5 Fondet nga rezerva mund të shfrytëzohet vetëm me Vendim të Bordit, në rrethanat dhe procedurat e parapara në aktet e brendshme.
- 18.6 Rezerva mund të rimbushet vetëm prej suficitit nga aktivitetet operationale, me Vendim të Bordit.

Neni 19 Ruajtja e evidencave

- 19.1 FKPK-ja do ta mbajë evidencën e administrimit të FKPK-së, duke përfshirë:
 - (a) Evidencën e të gjitha pranimeve dhe pagesave;
 - (b) Evidencën e të gjitha investimeve të blera apo të shitura;
 - (c) Të gjitha Vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të Bordit Drejtues, dhe gjithë korrespondencën përcjellëse.
- 19.2 Asnjë evidencë nuk duhet të shkatërrohet deri sa të mos mbarojë periudha për ruajtje, siç e parasheh ligji për arkivim, kërkesa ligjore specifike si dhe rregullat e brendshme të FKPK-së.

Neni 20 Nënshkrimet e autorizuara

- 20.1 Dokumentet zyrtare të FKPK-së mund të nënshkruhen vetëm nga personat e autorizuar dhe nënshkrimet e autorizuara të tyre (për fusha të ndryshme) si dhe nënshkrimet elektronike, rregullohen në kuadër të akteve të brendshme.

Neni 21 Parandalimi i konfliktit të interesit

- 21.1 Anëtarët e Bordit, dhe çdo zyrtar i FKPK-së, e ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private.
- 21.2 Në rast se zyrtari ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo Drejtorin Menaxhues. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet t'i pezullojë të gjitha veprimet që ndërlidhen me këtë çështje, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin.
- 21.3 Nëse zyrtari, nga paragrafi 2 i këtij neni, është vet Drejtori Menaxhues, ai duhet të konsultohet me Bordin Drejtues.
- 21.4 Nëse zyrtari nga paragrafi 2 i këtij neni, është anëtar i Bordit, ai duhet të konsultohet me Bordin Drejtues.

Trusti

- 21.5 FKPK-ja duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.
- 21.6 Në rast se Drejtori Menaxhues apo Bordi Drejtues nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit, apo dyshon se edhe vetë ka ose mund të ketë konflikt të interesit, atëherë i drejtohet Agjencisë për marrje të vendimit për rastin.

KREU III BORDI DREJTUES, PËRBËRJA, ZGJEDHJA, MANDATI

Neni 22 Përbërja e Bordit Drejtues

- 22.1 Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i FKPK-së.
- 22.2 Bordi përbëhet prej tetë (8) anëtarëve, të cilët janë fiduciarë sipas kuptimit të LFP-së, njëri prej të cilëve nuk ka të drejtë vote.
- 22.3 Anëtarët e Bordit duhet të jenë persona me integritet të njohur dhe duhet të posedojnë aftësi dhe përvojë profesionale në çështjet e pensionit, të financave, të investimeve dhe të sigurimit.
- 22.4 Anëtari pa të drejtë vote, sipas paragrafit 2 të këtij neni, është përfaqësues i Qeverisë në Bordin Drejtues dhe emërohet nga Kryeministri.

Neni 23 Zgjedhja dhe mandati i Anëtarëve të Bordit Drejtues

- 23.1 Anëtarët e Bordit të FKPK-së, përzgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, sipas procedurës së paraparë në LFP, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.
- 23.2 Kuvendi i emëron Anëtarët e Bordit Drejtues, duke përfshirë edhe Kryesuesin, bazuar në rekomandimet e komisionit për përzgjedhje, pas konsultimit me Qeverinë. Qeveria ia dorëzon opinionin e saj Kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së Kuvendit për konsultim.
- 23.3 Nëse mandati i Anëtarit skadon dhe asnjë anëtar i ri nuk është zgjedhur, atëherë Anëtari ekzistues do ta vazhdojë mandatin për më së shumti edhe nëntëdhjetë (90) ditë.
- 23.4 Në rast se Anëtari pasardhës zgjidhet brenda këtyre nëntëdhjetë (90) ditëve, atëherë mandati nëntëdhjetë (90) ditë përfundon në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për zgjedhjen e Anëtarit pasardhës.
- 23.5 Anëtari përfaqësues i Qeverisë së Kosovës do të shërbejë sipas emërimit nga Qeveria e Kosovës, në përputhje me LFP-në.
- 23.6 Pas përfundimit të mandatit të tyre si anëtarë të Bordit, Anëtarët nuk mund të shërbejnë në asnjë cilësi të profesionistit për ndonjë broker, menaxhues të mjeteve apo mbajtës të FKPK-së gjatë një periudhe prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

Neni 24 Ndërprerja e mandatit, dorëheqja

- 24.1 Anëtarit të Bordit mund t'i ndërpritet mandati vetëm nëse Anëtari bëhet i papërshtatshëm sipas dispozitave të LFP-së.
- 24.2 Organi përgjegjës do ta ndërpresë mandatin e Anëtarit duke ia komunikuar këtë në formë të shkruar, dhe një kopje e shkresës duhet t'i dorëzohet FKPK-së.
- 24.3 Anëtari i Bordit mund të japë dorëheqje nga pozita e tij/saj në çdo kohë. Akti i dorëheqjes i paraqitet për njoftim Kryesuesit të Bordit dhe Kuvendit të Kosovës.
- 24.4 Asnjë vend i lirë për pozitën e Anëtarit të Bordit nuk do ta pengojë fuqinë e Bordit për të administruar punët e FKPK-së, përderisa të ekzistojë kuorumi, siç është specifikuar në LFP dhe me këtë Statut.
- 24.5 Në çdo rast të përfundimit të mandatit, Anëtari i Bordit obligohet të bëjë kthimin e menjëhershëm të çfarëdo prone, materiali apo të dhëne tjetër të FKPK-së, në posedim (apo kontroll) të së cilës ka qenë në sajë të ushtrimit të funksionit të tij.
- 24.6 Pranim-dorëzimi i mandatit nga një Anëtar i Bordit në ikje të Anëtarit i ri i emëruar, do të rregullohen me procedura të brendshme të planifikimit të vazhdimësisë.

Neni 25 Kompensimi dhe shpenzimet

- 25.1 Për kryerjen e funksionit të Anëtarit të Bordit, Anëtarët, me përjashtim të Anëtarit Përfaqësues të Qeverisë, gëzojnë të drejtën e kompensimit në përputhje me dispozitat ligjore dhe parashikimet buxhetore të FKPK-së.
- 25.2 Lartësia e kompensimit mujor të Anëtarit të bordit, përcaktohet në Buxhetin vjetor të FKPK-së dhe hyn në fuqi me aprovimin e taksave (operacionale dhe investuese) nga Kuvendi për atë vit buxhetor.
- 25.3 Secili Anëtar do të kompensohet nga FKPK-ja për të gjitha shpenzimet që lidhen me ushtrimin e detyrës së Anëtarit të Bordit të FKPK-së.
- 25.4 Çfarëdo kompensimi i shpenzimeve për anëtarët e Bordit, përcaktohet në mënyrë të detajuar në aktet e brendshme.

KREU IV MBLEDHJET E BORDIT DREJTUES

Neni 26 Mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues

- 26.1 Bordi mbikëqyrë mbarëvajtjen e punëve dhe investimeve në FKPK. Bordi duhet të mbajë mbledhje të rregullt së paku një herë në tre (3) muaj.
- 26.2 Kryesuesi do t'i caktojë datat e mbledhjeve të Bordit, pas konsultimit me Anëtarët dhe Drejtorin Menaxhues.
- 26.3 Njoftimi për mbledhjen e Bordit, së bashku me rendin e ditës dhe dokumentet e tjera përcjellëse, i dërgohet me shkrim të gjithë anëtarëve nga Kryesuesi, të paktën shtatë (7) ditë para datës së caktuar për mbledhje.
- 26.4 Procesverbali i mbledhjes së Bordit mbahet nga Drejtori Menaxhues apo personi i caktuar nga Bordi dhe miratohet në mbledhjen e radhës.
- 26.5 Anëtarët e Bordit mund të marrin pjesë në mbledhje të Bordit edhe përmes telekonferencave apo online.

Neni 27 Mbledhjet e jashtëzakonshme

- 27.1 Kryesuesi, Anëtarët apo Drejtori Menaxhues i FKPK-së, mund të propozojnë mbledhje të jashtëzakonshme të Bordit Drejtues.
- 27.2 Propozimi i një Anëtari të Bordit apo Drejtorit Menaxhues, duhet të mbështetet nga së paku një Anëtar tjetër i Bordit para se të mbahet mbledhja e jashtëzakonshme.
- 27.3 Njoftimi për mbledhjen e jashtëzakonshme u dërgohet me shkrim të gjithë Anëtarëve të tjerë, së paku njëzetekatër (24) orë përpara datës së caktuar për këtë mbledhje.
- 27.4 Me rastin e propozimit të mbledhjes së jashtëzakonshme, duhet të propozohet rendi i ditës, koha, mënyra dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes.

Neni 28 Kuorumi

- 28.1 Para fillimit të çdo mbledhjeje të Bordit, të rregullt apo të jashtëzakonshme, duhet të konstatohet ekzistenca e kuorunit.
- 28.2 Ekziston kuorumi kur pjesëmarrës në mbledhje janë, së paku pesë (5) Anëtarë të Bordit Drejtues me të drejtë vote.

Neni 29 Votimi

- 29.1 Çdo veprim apo vendim që merret nga ana e Bordit duhet të bëhet me së paku katër (4) vota për (pro).
- 29.2 Në rastet kur ekziston vota e ndarë në dy pjesë të barabarta (tre pro dhe tre kundër/abstenim), atëherë Kryesuesi (apo Ushtruesi i Detyrës së Kryesuesit) do të shfrytëzojë votën e dytë për ta zhbllokuar këtë barazim.
- 29.3 Nëse Kryesuesi nuk mundet, ose për çfarëdo arsye nuk e përdor votën për ta zhbllokuar barazimin, atëherë çështja nuk kalon.
- 29.4 Përfaqësimi në votim të çështjeve, nuk lejohet. Për të votuar, Anëtari duhet të jetë personalisht prezent fizikisht ose përmes linjës telefonike apo formave të tjera të komunikimit. Mënyra e votimit përmes formave të tjera të komunikimit rregullohet në mënyrë të detajuar në aktet e brendshme.
- 29.5 Propozimet për shqyrtim të çështjeve të parregulluara me aktet e brendshme, mund të paraqiten nga Kryesuesi apo cilido Anëtar i Bordit, Komisionet e Bordit apo Drejtori Menaxhues.

- 29.6 Propozimet për shqyrtim të paraqitura sipas par. 5 të këtij neni, duhet të mbështeten nga së paku edhe një Anëtar tjetër i Bordit, para se çështja të hidhet në votim.
- 29.7 Secili Anëtar mund të përkrahë ose jo propozimet përmes votimit, duke vepruar si fiduciar me përgjegjësi ndaj pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve.
- 29.8 Secili Anëtar i Bordit, merr masa për vetë përjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt interesi me përjashtim të rasteve të përcaktuar shprehimisht me ligj;

Neni 30 Kryesuesi i Bordit

- 30.1 Kryesuesi i Bordit emërohet nga Kuvendi.
- 30.2 Kryesuesi i kryeson dhe përcakton agjendën e mbledhjeve të Bordit Drejtues. Në mungesë të tij mbledhjet i kryeson një anëtar tjetër të cilin ai e emëron si ushtrues detyre.
- 30.3 Kryesuesi i FKPK-së bën emërimin e anëtarëve të komisioneve të Bordit.
- 30.4 Kryesuesi do ta përfaqësojë Bordin Drejtues brenda dhe jashtë vendit, si dhe do të marrë përsipër detyra të tjera të cilat mund t'i caktohen nga Bordi Drejtues.
- 30.5 Në rast se Kryesuesit të Bordit të emëruar nga Kuvendi i përfundon mandati, qoftë me dorëheqje apo sipas mënyrave të tjera ligjore, çështja adresohet në Kuvend.
- 30.6 Deri në emërimin e Kryesuesit të ri të Bordit nga Kuvendi, Anëtarët e Bordit me shumicë votash emërojnë një Ushtrues Detyre të Kryesuesit të Bordit, nga radhët e veta.

KREU V KOMISIONET

Neni 31 Komisionet

- 31.1 Bordi themelon komisionet e përhershme, anëtarët e të cilave i emëron Kryesuesi në përputhje me këtë Statut dhe me aktet e brendshme.
- 31.2 Bordi me vendim të veçantë, në përputhje me aktet e brendshme, sipas nevojës mund të krijojë edhe komisione shtesë ose nën-komisione, si dhe komisione ad-hoc, anëtarët e të cilëve emërohen nga Kryesuesi.
- 31.3 Drejtori Menaxhues dhe anëtarët e tjerë të stafit menaxhues të FKPK-së mund të emërohen si anëtarë të komisioneve (përveç Komisionit për Auditim).
- 31.4 Detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme paraqiten në aktet e brendshme në mënyrë të detajuar.

Neni 32 Komisionet e përhershme

- 32.1 Bordi Drejtues i ka këto komisione të përhershme me nga së paku tre (3) anëtarë:
- (a) Komisioni për Investime
 - (b) Komisioni për Buxhet
 - (c) Komisioni për Ankesa
 - (d) Komisioni për Auditim
- 32.2 Funkcionimi dhe përbërja e Komisioneve, mbledhjet, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe procedurat që duhen ndjekur, parashihen në detaje në aktet e brendshme.

Neni 33 Komisioni për Investime

- 33.1 Komisioni për Investime është përgjegjës për shqyrtimin e vazhdueshëm të Deklaratës së Parimeve të Investimeve, si dhe çështjet që ndërlidhen me investimin e mjeteve pensionale, si dhe i jep rekomandimet e nevojshme për veprimet përkatëse në Bordin Drejtues.
- 33.2 Komisioni për Investime, e bën shqyrtimin e Deklaratës së Parimeve të Investimeve, së paku një herë në vit.
- 33.3 Komisioni për Investime vepron në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të fiduciaritetit, maturisë dhe kujdesit; të cilat profesionistët me përvojë investuese i zbatojnë, si dhe në pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret.

Neni 34 Komisioni për Buxhet

- 34.1 Komisioni për Buxhet është përgjegjës për përgatitjen e buxhetit vjetor dhe propozimin për miratimin e të njëjtit në Bord.
- 34.2 Komisioni për Buxhet bën rishikimin e buxhetit dhe propozimin e ndryshimeve për miratim nga Bordi.
- 34.3 Propozimi për buxhetin vjetor përfshin edhe nivelin e taksave operationale dhe investuese që do të kërkohen për miratim nga Kuvendi.
- 34.4 Kryesuesi i Bordit është po ashtu Kryesues i këtij Komisioni.

Neni 35 Komisioni për Ankesa

- 35.1 Komisioni për Ankesa është përgjegjës për t'i trajtuar ankesat e pjesëmarrësve apo shfrytëzuesve, që lidhen me kursimet pensionale.
- 35.2 Komisioni për Ankesa, po ashtu, vepron si shkallë e dytë në procedurën disiplinore brenda FKPK-së.

Neni 36 Komisioni i Auditimit

- 36.1 Komisioni i Auditimit është përgjegjës që, përmes trajtimit të çështjeve të auditimit (të financave, IT, etj.) t'i ofrojë siguri Bordit Drejtues dhe palëve të jashtme për mbarëvajtjen e proceseve në FKPK.
- 36.2 Në përputhje me kërkesat ligjore, Komisioni i Auditimit duhet të ketë në përbërje të tij së paku një anëtar i cili duhet të jetë ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit dhe i cili është i pavarur nga Menaxhmenti dhe Bordi Drejtues.
- 36.3 Anëtari i Jashtëm i Komisionit të Auditimit përzgjidhet me konkurs publik dhe emërohet me Vendim të Bordit.

Neni 37 Komisionet e Përkohshme apo Ad-hoc

- 37.1 Bordi Drejtues mund të themelojë, sipas nevojës, Komisione të Përkohshme apo Ad-hoc.
- 37.2 Numri i anëtarëve, detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i tyre, përcaktohen në Vendimin e Bordit për themelimin e tyre.
- 37.3 Kryesuesi i Bordit emëron anëtarët në përputhje me Vendimin e Bordit.

KREU VI TË DREJTAT, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES

Neni 38 Të drejtat e Anëtarit të Bordit Drejtues

- 38.1 Në ushtrimin e funksionit, Anëtari ka të drejtën që të ketë qasje në të dhënat, materialet zyrtare dhe dokumentet që janë të përgatitura dhe të mbledhura nga komisionet e Bordit apo Administrata e FKPK-së.
- 38.2 Në ushtrimin e funksionit, Anëtari ka të drejtë të jetë i informuar apo të kërkojë sqarime me gojë ose me shkrim për çështjet që janë në kompetencë të Kryesuesit apo Kryesuesve të Komisioneve.
- 38.3 Me aprovimin e anëtarëve të tjerë të atij Komisioni, Anëtari mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve ku ai nuk është anëtar, mirëpo pa të drejtë vote.
- 38.4 Anëtarët gëzojnë të drejtën të kenë polica të sigurimit, të siguruara nga FKPK-ja, për të qenë të mbrojtur në kuadër të aktiviteteve të tyre në emër të FKPK-së.
- 38.5 Anëtarët mund të marrin pjesë në organizime të natyrës edukative, legjislative, apo të ngjashme, si përfaqësues të FKPK-së. Kur këto pjesëmarrje bartin me vete kosto financiare, nevojitet Vendimi i Bordit.

Neni 39 Detyrat e përgjithshme

- 39.1 Çdo Anëtar i Bordit është fiduciar sipas kuptimit të LFP-së.
- 39.2 Bordi Drejtues administron FKPK-në në përputhshmëri me LFP-në dhe me të gjitha ligjet e aplikueshme, rregullat, rregulloret dhe udhëzimet administrative në fuqi.
- 39.3 Bordi Drejtues administron mjetet pensionale dhe bën investimin e tyre për përfitimin e vetëm dhe ekskluziv të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.
- 39.4 Bordi Drejtues i miraton aktet e brendshme (OPP) i cili i përshkruan në detaje përgjegjësitë, politikat dhe procedurat e kërkuara për administrim efektiv të FKPK-së.

Neni 40 Kompetencat e Bordit Drejtues

- 40.1 Bordi ka autoritet të plotë dhe ekskluziv për të kontrolluar dhe administruar FKPK-në, përveç nëse kufizohet shprehimisht me Ligj apo në këtë Statut.
- 40.2 Bordi ka autoritet të plotë të ndërmarrë çfarëdo veprimi, përfshirë këtu edhe shpenzimin e parave të FKPK-së, kur kjo vlerësohet të jetë e domosdoshme për të përmbushur qëllimin e FKPK-së.
- 40.3 Bordi kompetencat e veta i ushtron përmes marrjes së vendimeve, miratimit dhe zbatimit të rregullave procedurave dhe politikave përkatëse.

Neni 41 Bartja e kompetencave nga Bordi Drejtues

- 41.1 Bordi Drejtues, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive dhe aty ku vlerësohet si e duhur, mund të bartë kompetenca të caktuara te komisionet e tij, te Drejtori Menaxhues, apo te ndonjë instancë tjetër brenda strukturës organizative të FKPK-së, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me një akt juridik më të lartë.
- 41.2 Kompetencat e bartura, me Vendim të Bordit, mund të rimerren.

Neni 42 Raportimi

- 42.1 Bordi Drejtues do të paraqesë në Kuvend raportin vjetor, përfshirë pasqyrat e audituara financiare, jo më vonë se pesë (5) muaj pas përfundimit të vitit kalendarik.

- 42.2 Raporti vjetor duhet të përmbajë informatat e kërkuara me legjislacionin në fuqi.
- 42.3 Pasqyrat e audituara financiare i dërgohen BQK-së jo më vonë se 30 prilli i vitit pasues.
- 42.4 FKPK-ja ia paraqet raportet e tjera periodike Kuvendit, BQK-së dhe Qeverisë, duke respektuar afatet dhe përmbajtjen e paraparë në legjislacionin në fuqi.
- 42.5 Publikimi i informatave në përputhje me legjislacionin në fuqi, bëhet në faqen elektronike zyrtare të FKPK-së.

Neni 43 Auditimi i jashtëm

- 43.1 Pasqyrat financiare përgatiten ndaras për mjetet pensionale të pjesëmarrësve dhe për mjetet operacionale.
- 43.2 Auditimi i pasqyrave financiare bëhet nga auditori i jashtëm, i licencuar sipas kërkesave ligjore.
- 43.3 Bordi, me rekomandimin e Komisionit të Auditimit, cakton kriteret për përzgjedhjen, përmes prokurimit publik, të auditorit të jashtëm të kualifikuar dhe të pavarur, të miratuar nga BQK-ja.
- 43.4 Auditorit të jashtëm do t'i ofrohet qasje në të gjitha materialet relevante të FKPK-së.

KREU VII KONTRIBUTET DHE PAGESA E TYRE

Neni 44 Kontributet

- 44.1 Baza mbi të cilën kontributet e punëdhënësve dhe punonjësve paguhen në FKPK buron nga LFP-ja, ndërkohë që raportimi dhe pagesa e tyre bëhet sipas procedurave të parapara nga ATK-ja.
- 44.2 Kontributet e paguara në FKPK regjistrohen në llogaritë individuale në emër të pjesëmarrësve, në momentin e pranimit nga punëdhënësi të pagesës dhe informacionit se kujt i takojnë ato kontribute të paguara.
- 44.3 Mjetet pensionale të alokuara në llogaritë individuale janë pronë e pjesëmarrësve përkatës.
- 44.4 E drejta e pronës mbi mjetet pensionale, është kufizuar në atë mënyrë që e drejta për të marrë ose për të shfrytëzuar pronën mund të bëhet vetëm në kohën e moshës së pensionimit, vdekjes ose të paaftësisë fizike të pjesëmarrësit, siç parashihet me LFP dhe Rregullore të BQK-së.
- 44.5 Kjo e drejtë e pronës nuk mund të lihet peng, të ndalet, të transferohet, ose të tjetërsohet. Ajo nuk i nënshtrohet ekzekutimit, nuk është pjesë e paluajtshmërisë në rast të falimentimit të pjesëmarrësit dhe në të nuk mund të ndikojë kurrfarë procedure e marrëveshjes dhe çdo përpjekje për ta bërë këtë do të jetë e pavlefshme.

Neni 45 Baza e Përfitimeve nga FKPK-ja

- 45.1 Baza mbi të cilat mjetet pensionale shpaguhen nga FKPK-ja për tërheqje të kursimeve rregullohen me dispozitat përkatëse të LFP-së dhe Rregulloreve të BQK-së, duke respektuar edhe ligjet përkatëse tatimore.
- 45.2 FKPK-ja e bën shpagimin e fitimeve të llogarive individuale për pensionet e kursyera siguruesve të anuiteteve me qëllim të blerjes së pensioneve për pjesëmarrësit dhe përfituesit në përputhje me LFP-në.
- 45.3 Në mungesë të siguruesve të anuiteteve, FKPK-ja me pëlqim të BQK-së, arrin marrëveshje me institucionet financiare për ofrimin e tërheqjes në faza të pensioneve.
- 45.4 Detajet lidhur me procedurën e pagesës si dhe përgjegjësitë mbi të njëjtat përshkruhen në aktet e brendshme.
- 45.5 Faqja zyrtare e FKPK-së do të paraqesë në mënyrë të përditësuar bazën mbi të cilën mund të bëhet tërheqja e kursimeve, dokumentet e nevojshme dhe procedurën që duhet ndjekur.

Neni 46 Pasqyrat për pjesëmarrësit

- 46.1 FKPK-ja sigurohet që pjesëmarrësit, në përputhje me LFP-në, të informohen për kontributet, datat e kontributeve, shumën e fitimit nga investimi dhe bilancin e mjeteve në llogarinë individuale.
- 46.2 Pas përfundimit të një viti kalendarik pjesëmarrësit pranojnë pasqyrën vjetore përmes dërgesës postare ose përmes postës elektronike, me të dhënat si në paragrafin 1 të këtij neni, përfshirë edhe nivelin dhe shumën e taksave të ngarkuara mbi llogarinë përkatëse.
- 46.3 Pjesëmarrësit mund të kërkojnë informacion lidhur me kontributet e tyre, përmes qasjes online në llogari apo paraqitjes së tyre fizike në FKPK-së.

46.4 Bordi mund të vendosë që pjesëmarrësit, të cilët shërbehen me pasqyrë në zyrat e FKPK-së, të ngarkohen me një tarifë të arsyeshme për pranimin e këtij shërbimi. Niveli i kësaj tarife duhet të publikohet në faqen zyrtare të FKPK-së dhe procedurat e mbledhjes rregullohen me aktet e brendshme.

Neni 47 Procedura për shqyrtimin e ankesave

47.1 Pjesëmarrësit apo përfituesit e tyre mund të paraqesin ankesa në FKPK, të cilat do të shqyrtohen nga Komisioni i Ankesave.

47.2 Procedura e shqyrtimit të ankesave rregullohet në aktet e brendshme.

47.3 Palët e gëzojnë të drejtën e përdorimit të mjeteve juridike në instanca më të larta.

Neni 48 Përmirësimi i të dhënave

48.1 Në kuadër të akteve të brendshme zhvillohen procedurat e detajuara për përmirësimin e të dhënave të pasakta apo plotësimin e të dhënave të mangëta, e që lidhen me pjesëmarrësit, punëdhënësit apo kontributet e pranuar.

48.2 Në rast se FKPK-ja bën pagesa të kursimeve pensionale tek përfituesit e gabuar, FKPK-ja ndërmerr masa për kthimin e këtyre pagesave.

KREU VIII ADMINISTRIMI I FKPK-SË

Neni 49 Organizimi i brendshëm i FKPK-së

- 49.1 FKPK-ja udhëhiqet nga Bordi Drejtues dhe organizohet në këto njësi administrative:
- 49.1.1 Drejtori Menaxhues
 - 49.1.2 Drejtorët
 - 49.1.3 Njësitë
- 49.2 Njësitë administrative, sipas pikave 1.2 dhe 1.3. të këtij neni, organizohen në madhësi të përshtatshme bazuar në funksionin dhe kompleksitetin përkatës.
- 49.3 Njësitë administrative, sipas pikës 1.2 të këtij neni, duhet të kenë së paku dy Njësi nën menaxhim.
- 49.4 Struktura organizative e FKPK-së, rregullohet tutje me aktet e brendshme.

Neni 50 Drejtori Menaxhues i FKPK-së

- 50.1 Drejtori Menaxhues, është zyrtari kryesor përgjegjës për administrimin e përditshëm të FKPK-së dhe personelit.
- 50.2 Drejtori Menaxhues i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit Drejtues dhe e ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e Bordit.
- 50.3 Drejtori Menaxhues i mbikëqyr të gjitha aktivitetet e FKPK-së, përfshirë:
- (a) Mbajtjen e shënimeve për të gjitha pagesat dhe kontributet;
 - (b) Mirëmbajtjen e llogarive individuale;
 - (c) Raportimin tek pjesëmarrësit;
 - (d) Komunikimin me entitetet e tjera relevante në Kosovë;
 - (e) Aranzhimet me ATK-në dhe BQK-në për mbledhjen e kontributeve dhe informatave për pagesat individuale;
 - (f) Përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Bordit;
 - (g) Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve, dhe deklaratat vjetore për publik;
 - (h) Si dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara në aktet e brendshme.
- 50.4 Drejtori Menaxhues mbështetet në punën e tij nga stafi profesional dhe mbështetës.
- 50.5 Drejtorit Menaxhues duhet të jetë person me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, e me eksperiencë dhe punësimi i tij bëhet në përputhje me Ligjin e Punës.
- 50.6 Përzgjedhja bëhet nga Bordi, përmes konkursit publik, kushtet dhe procedurat e të cilit përcaktohen me parë.
- 50.7 Bordi Drejtues përcakton parametrat e performancës dhe matësit për kompensimin dhe pagën, vlerëson performancën, cakton masat disiplinore dhe inicion procedurat për votimin për shkarkimin e Drejtorit Menaxhues.
- 50.8 Pranim-dorëzimi i mandatit nga Drejtori Menaxhues në largim te Drejtori Menaxhues pasardhës, do të rregullohen me procedura të brendshme të planifikimit të vazhdimësisë.

Neni 51 Drejtorët

- 51.1 Drejtorët e FKPK-së duhet të jenë persona me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, të ndershëm, e me përvojë të duhur.
- 51.2 Procedurat e punësimit të Drejtorëve do të zhvillohen në pajtim të plotë me kërkesat e ligjit të punës dhe akteve të tjera ligjore të aplikueshme.
- 51.3 Drejtorët i raportojnë Drejtorit Menaxhues të FKPK-së.

- 51.4 Detyrat dhe përgjegjësitë për pozitat e Drejtorëve përcaktohen në aktet të brendshme.
- 51.5 Punësimi i Drejtorëve bëhet me Vendim të Bordit, në përputhje me Ligjin e Punës.
- 51.6 Komisioni përzgjedhës për pozitat e Drejtorëve përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe dy anëtarë të Bordit.
- 51.7 Për përzgjedhjen e Drejtorëve, Komisioni përzgjedhës i rekomandon me shumicë votash Bordit, ku njëra nga votat për (pro), duhet të jetë e Drejtorit Menaxhues.
- 51.8 Bordi Drejtues përcakton parametrat e performancës dhe matësit sipas të cilëve Drejtori Menaxhues vlerëson performancën dhe përcakton pagën e Drejtorëve në përputhje me aktet e brendshme. Po ashtu, cakton masat disiplinore ndaj Drejtorëve.
- 51.9 Drejtori Menaxhues inicion procedurat mbi shkarkimin e Drejtorëve, për të cilin akt nevojitet pëlqimi i Bordit Drejtues.
- 51.10 Në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorin Menaxhues, Drejtorët janë përgjegjës për të siguruar mbarëvajtjen e operacioneve ditore të FKPK-së, në pajtim me kërkesat në aktet e brendshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në fushën e:
- (a) Financave,
 - (b) Investimeve
 - (c) Menaxhimit të riskut,
 - (d) TI-së dhe operacioneve,
 - (e) Burimeve njerëzore etj.
- 51.11 Pranim-dorëzimi i mandatit nga Drejtori në largim të Drejtorit pasardhës, do të rregullohet me procedura të brendshme të planifikimit të vazhdimësisë.

Neni 52 Menaxherët

- 52.1 Procedurat e punësimit për menaxherët e Njësive, zhvillohen në pajtim të plotë me kërkesat e ligjit të punës dhe akteve të tjera ligjore të aplikueshme.
- 52.2 Detyrat dhe Përgjegjësitë për cilëndo pozitë të Menaxherit, përcaktohen me vendim të Drejtorit Menaxhues, në përputhje me aktet e brendshme.

Neni 53 Stafi profesional dhe mbështetës

- 53.1 Në administrimin e përditshëm të FKPK-së, Drejtori Menaxhues mbështetet në profesionalizmin dhe asistencën e stafit profesional dhe mbështetës.
- 53.2 Punësimi i stafit profesional dhe atij mbështetës të FKPK-së bëhet nga Drejtori Menaxhues, në përputhje me Ligjin e Punës, sipas procedurave të parapara në aktet e brendshme.
- 53.3 Detyrat dhe përgjegjësitë për secilën pozitë të punës e cila duhet të mbulohet, caktohen nga Drejtori Menaxhues, në përputhje me nevojat e FKPK-së.

Neni 54 Njësia e Auditimit të Brendshëm

- 54.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm është përgjegjëse për auditimin e rregullt të aktiviteteve të FKPK-së.
- 54.2 Njësia udhëhiqet nga Auditori i Brendshëm, i cili përzgjidhet nga Bordi Drejtues përmes konkursit publik, me rekomandim të Komisionit të Auditimit.
- 54.3 Punësimi i punonjësve tjerë në kuadër të Njesisë bëhet me Vendim të Bordit, me propozim të komisioni përzgjedhës që përbëhet nga Auditori i Brendshëm, Kryesuesi i Komisionit të Auditimit dhe një anëtar tjetër të Bordit Drejtues.

Trusti

- 54.4 Auditori i Brendshëm i FKPK-së i raporton komisionit të auditimit dhe funksionon në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti i FKPK-së.
- 54.5 Në rast të nevojës për shërbime të specializuara të auditimit të brendshëm, kriteret dhe përzgjedhja bëhen nga Komisioni i Auditimit në konsultim me Auditorin e Brendshëm.

KREU IX TË NDRYSHME

Neni 55 Përfaqësuesit e FKPK-së

- 55.1 FKPK-ja është entitet i veçantë dhe i pavarur sikurse parashihet me LFP.
- 55.2 Asnjë individ apo organizatë nuk mund të veprojë apo funksionojë për apo në emër të FKPK-së apo si përfaqësues i saj, përveç nëse autorizohet me vendimin e Bordit Drejtues apo të Drejtorit Menaxhues.

Neni 56 Përgjegjësia për shkeljet, dëmet dhe detyrimet e tjera

- 56.1 Asnjë Anëtar i Bordit Drejtues nuk do të jetë personalisht përgjegjës për shkelje të përgjegjësive fiduciare në FKPK, të kryera para zgjedhjes së tij si Anëtar i Bordit Drejtues.
- 56.2 Përgjegjësia fiduciare, për periudhën gjatë së cilës është ushtruar funksioni i Anëtarit të Bordit, nuk pushon me ndërprerjen e mandatit.
- 56.3 Asnjë Anëtar i Bordit nuk do të jetë personalisht përgjegjës për detyrimet dhe borxhet e FKPK-së.
- 56.4 Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e FKPK-së, nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet, detyrimet, kërkesat, shpenzimet, vendimet dhe shpenzimet e shkaktuara gjatë ushtrimit të detyrave të veta, përveç nëse me vendim gjyqësor vendoset se dëmet kanë rezultuar nga sjellja e keqe e qëllimshme apo pakujdesia e rëndë.
- 56.5 FKPK-ja do të paguajë në paradhënie për shpenzimet e mbrojtjes ligjore për personat e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni. Shpenzimet për mbrojtjen ligjore dhe pagesa në paradhënie duhet të aprovohen nga Bordi Drejtues, në përputhje me procedurat në fuqi, që ndërlidhen me shfrytëzimin e rezervës operacionale.
- 56.6 Shpenzimet për dëmet dhe mbrojtjen ligjore të përmendura në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni, në asnjë rrethanë nuk përfshijnë shpenzime të ndërlidhura me aktakuza të ngritura për kryerjen e një vepre penale.

KREU X LIGJI I ZBATUESHËM DHE INTERPRETIMI

Neni 57 Ligji dhe rregullat e aplikueshme

- 57.1 Ky Statut do të interpretohet në përputhje me LFP-në, me përmirësime të mundshme të kohëpaskohshme, si dhe ligjet dhe rregullat e tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
- 57.2 Referencat e këtushme, për ndonjë nen të veçantë të LFP-së, do t'i përfshijnë ato rregulla përkatëse për ato nene, ashtu siç nxirren nga autoritetet zbatuese në Kosovë dhe çfarëdo përmirësimesh pasuese në këto ligje dhe rregulla.

Neni 58 Ndryshimet dhe interpretimi

- 58.1 Çdo ndryshim në këtë Statut miratohet me vendim të Bordit Drejtues dhe hyn në fuqi pas pëlqimit të BQK-së.
- 58.2 Bordi Drejtues do t'i nxjerrë procedurat e nevojshme në kuadër të akteve të brendshme për implementimin e dispozitave të këtij Statuti.
- 58.3 Bordi Drejtues e ka autoritetin ekskluziv për ta interpretuar dhe zbatuar këtë Statut, duke iu nënshtruar mbikëqyrjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe BQK-së, siç është caktuar në LFP.

KREU XI DISPOZITA KALIMTARE

Neni 59 Shfuqizimi

- 59.1 Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i datës 10.09.2019.
- 59.2 Të gjitha vendimet, politikat dhe dokumentet tjera të miratuara nga Bordi Drejtues duke u bazuar në Statutin e mëparshëm mbasin në fuqi deri në shfuqizimin apo zëvendësimin nga Bordi Drejtues.
- 59.3 Të gjitha aktet juridike që burojnë nga Statuti, do të harmonizohen jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
- 59.4 Të gjitha referencat ndaj Statuteve paraprake të miratuara në mbledhjet e kaluara të Bordit Drejtues, në vendime, politika e dokumente të tjera do të interpretohen si referenca ndaj dispozitave përkatëse autorizuese në këtë Statut.

KREU XII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 60 Hyrja në fuqi

- 60.1 Ky Statut u miratua nga Bordi Drejtues më 31.10.2023 dhe hyn në fuqi pas marrjes së pëlqimit nga BQK.

Kryesuesi i Bordit Drejtues të FKPK-së

Prishtinë